



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 82, DATË 08.10.2020

MBI

**VIJIMIN E PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT TË TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE  
NË QARQET DIBËR, GJIROKASTËR DHE KUKËS**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: AMA kryesisht,

Objekt: Mbi vijimin e procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive në qarqet Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e Strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike”

**VËREN SE:**

Në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Strategjisë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike si dhe vendimit të AMA-s, nr. 51, datë 29.06.2020, në datën 30 shtator 2020, janë mbyllur transmetimet analoge në qarqet Elbasan, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë, duke çuar në 9 (nëntë), numrin e qarqeve ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit. Tashmë kanë mbetur vetëm 3 qarqe, konkretisht qarqet Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës ku qytetarët aksesojnë ende transmetimet analoge. Me mbylljen e transmetimeve analoge në këto qarqe do të arrihet edhe finalizimi i plotë i procesit të digjitalizimit, duke përmbytur në këtë mënyrë këtë detyrim kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, me qëllim vijueshmërinë e procesit të digjitalizimit në tre qarqet e mbetura, AMA ka vijuar monitorimin në terren për identifikimin e mbulimit me sinjal numerik të këtyre qarqeve.

Nga këto monitorime rezulton se:

Operatori publik shqiptar (RTSH) e ka shtruar infrastrukturën numerike në të gjithë Shqipërinë. Ndërkohë operatorët privatë numerikë vijojnë të shtrojnë infrastrukturën e tyre.

Konkretisht në qarqet Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës, situata në terren lidhur me infrastrukturën numerike të operatorëve privatë, paraqitet si më poshtë:

*Allotmenti Dibër:*

- Në pikën e transmetimit Arapaj (Peshkopi) ka ndezur transmetuesin vetëm operatori “TV Klan” duke mbuluar kryesisht Bashkinë Dibër;
- Në pikat e transmetimit Burrel dhe Homesh nuk janë ndezur transmetuesit nga asnjë nga operatorët privatë numerikë.

Bashkitë të cilat nuk mbulohen me sinjal numerik në qarkun Dibër janë Bashkitë Bulqizë, Klos dhe Mat të qarkut Dibër,

*Allotmenti Gjirokastrë:*

- Në pikën e transmetimit Asim Zenel kanë ndezur transmetuesit të gjithë operatorët privatë numerikë duke mbuluar kryesisht Bashkinë Gjirokastrë;
- Në pikat e transmetimit Gllavë dhe Përmet nuk janë ndezur transmetuesit nga asnjë nga operatorët privatë numerikë.

Bashkitë të cilat nuk mbulohen me sinjal numerik në qarkun Gjirokastrë janë Bashkitë Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull të qarkut Gjirokastrë.

*Allotmenti Kukës:*

- Në pikën e transmetimit Tregtan (Kukës) kanë ndezur transmetuesit operatorët Tv Klan dhe Vizion Plus duke mbuluar me sinjal numerik Bashkinë Kukës;
- Në pikat e transmetimit Bajram Curri, Midë dhe Qafë Prushë nuk janë ndezur transmetuesit nga asnjë operator privat numerik.

Bashkitë të cilat nuk mbulohen me sinjal numerik në qarkun Kukës janë Bashkitë Has dhe Tropojë.

AMA, lidhur me procesin e digjitalizimit, raporton periodikisht pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë si dhe Komisionit Europian pasi në rekomandimet e këtyre institucioneve në mënyrë të përsëritur është vënë theksi tek finalizimi i këtij procesi.

Duke konsideruar rëndësinë e përmbushjes së këtij detyrimi në një kohë sa më të shkurtër si dhe duke marrë në konsideratë realizimin me sukses të procesit të mbylljes së transmetimeve analoge, AMA përcakton që afati përfundimtar për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës të jetë data 30 dhjetor 2020.

Gjatë kësaj periudhe, AMA do të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore, si vijimin e fushatës së informimit të publikut në allotmentet Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës, koordinimin me operatorët audiovizivë kombëtarë me qëllim marrjen e masave të nevojshme nga ana e tyre për instalimin e pikave të mbetura të transmetimit në allotmentet e sipërcituara si dhe mbulimin e plotë të territorit të këtyre qarqeve me sinjal numerik, koordinimin me operatorët audiovizivë lokalë/rajonalë të këtyre qarqeve me qëllim mbështetjen e programeve të tyre në rrjetet kombëtare numerike, si dhe vlerësimin lidhur me pajisjen e banorëve me pajisje marrëse DVB-T2 në këto qarqe.

## **PËR KËTO ARSYE**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

1. Afati për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës të jetë data 30 dhjetor 2020.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Zëvendëskryetar:**

**Anëtarë:**

**Gentian**

**Sami**

**Agron**

**Gledis**

**Suela**

**SALA**

**NEZAJ**

**GJEKMARKAJ**

**GJIPALI**

**MUSTA**

